

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER AKTIVITETIN

“RIPARIM DHE MIREMBAJTJE E PJESEVE MEKANIKE DHE TE MOTORRIT, TE MJETEVE RRUGORE ME MOTORR DHE RIMORKO. BLERJA DHE SHITJA E MJETEVE ME MOTORR DHE RIMORKO”

(SUBJEKTI: AGRON GORICA)



PROJEKTUES	INXHINIER PROJEKTUES	SUBJEKTI POROSITES	Rev
INSTITUTI “DEKLIADA – ALB” SH.P.K Studim,Projektim,VleresimTrajnim, Konsulencë Adresa: rr. Milto TUTULANI, perballë f. Juridik. Tirane Tel. Fax: 00355/ 69 20 78 555 E-mail: dekliadaalb.shpk@gmail.com	Ekspert Mjedisi: AGIM HASALAMI Ing.Gjeomjedisi: BLEDAR HASALAMAJ  Agim Hasalami Mjedisi Certificate Nr: 429	 Personi Fizik: Agron Gorica Miratuar	00
 		Nr. fq/Formati 14/A4 /A3	2019 Tirane
TITULLI PROJEKTIT	Permbledhje jotechnike		

PERMBAJTJA E PUNIMIT

- *Pershkrimi i projektit*
- *Informacion per qellimin e VNM dhe metodiken e zbatuar*
- *Pershkrimi i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti*
- *Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te saj*
- *Identifikimi indikimeve te mundshme negative ne mjedis*
- *Pershkrimi i shkarkimeve te mundshme ne mjedis*
- *Informacioni per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative*
- *Shtrirja hapesinore e ndikimit negativ ne mjedisin e zones*
- *Rehabilitimi i mjedisit te ndikuar dhe mundesia e kthimit te tij ne gjendjen e meparshme*
- *Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis*
- *Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille)*

Ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, hartohet me kerkese te Personit Fizik "Agron Gorica" me numer NIPT K315161770, adresa: Tirane Vaqarr VAQARR Lagjja Vaqarr, Rruga Nacionale Tirane - Vaqarr, Godine 1 - kateshe, nr.2.

Ky Person Fizik, ka paraqitur kerkesen per hartimin e procedures se konsultimit me publikun prane AKM dhe do te aplikojte prane QKB-AKM per **pajisjen me Leje Mjedisore te tipit B per aktivitetin: Riparim dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorrit, te mjeteve rrugore me motorr dhe rimorko. Blerja e shitja e mjeteve me motorr e rimorko.** Ky aktivitet ndodhet ne qarkun Tirane, bashkine Tirane, NJQV Vaqarr, Zona kadastrale 3712, nr pasurie 300/37, lloji i pasurise Arre/, adresa e pasurise Vaqarr, rruga Nacionale Tirane - Vaqarr, ambient i hapur.

Permbledhja joteknike e raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, parashikon ndikimet negative dhe positive ne mjedis qe mund te shkaktoje aktiviteti, masat qe jane marre e duhet te merren nga subjekti zhvillues me qellim minimizimin e ndotjes dhe zbatimin e kuadrit ligjor mjedisor ne fuqi per vendin tone. *Bazuar ne shtojcat I dhe II te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", i ndryshuar, ky aktivitet nuk perfshihet ne listen e aktiviteve te cilat duhet ti nenshtrohen procedures paraprake ose te thelluar te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, si rrjedhoje ky aktivitet mund te aplikojte direkt dhe vetem per pajisjen me leje mjedisore te tipit B sipas ligjit nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar.*

- ❖ Aktiviteti merr ne konsiderate masat e nevojshme per te siguruar qe menaxhimi i tyre te kryhet pa demtuar shendetin e njeriut dhe pa i sjell deme mjedisit vecanerisht:
 - Pa krijuar rreziqe per ujin, ajrin, token, floren ose faunen
 - Pa shkaktuar pengesa per banoret e zones nga zhurmat
 - Pa demtuar peisazhin per rreth

Nje synim tjetër është të përcaktoje e rekomandoje masat teknike organizative për zbatimin e ndikimeve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit. Në këtë aktivitet të personit fizik Agron Gorica do të punësohen disa punonjës për kryerjen e punës dhe mirëfunksionimin e saj në vazhdimësi.

Ndodhja e mjedisit nënkupton shkarkimet e çdo lloji mbetje nga pjesë të materialeve të ndryshme në ujë, tokë, ajër e cila shkakton ose mund të shkaktojë probleme mjedisore të perkoheshme ose të përhershme në balancën ekologjike të tokës.

Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vlerësojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Objektivat afatshkurter të VNM janë:

- Përmirësim nga pikepamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrën e duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundëson informimin e vendim-marrësve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit.

Objektivat afatgjatë të VNM janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;

- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/dentimet e pakthyeshme te mjedisit;
- Ndikon ne mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike te projektit
- Ndhmon ne realizimin e parimit te zhvillimit te qendrueshem te mjedisit.

Pershkrim i permbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional qe lidhet me projektin, Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe dentimin e komponenteve te vecante dhe te rendesishem te mjedisit nga faktore te ndryshem, njerezore dhe natyrore.

Kuadri Ligjor

Ligje

- **Ligji nr.10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar**
- Ligji nr. 81/2017 “ Per Zonat e mbrojtura”
- Ligji, Nr.107/2014, " Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar
- Ligji nr.60/2014, date 19.06.2014 “Per disa ndryshime ne ligjin nr.10448, date 14.07.2011 “Per lejet mjedisore”, te ndryshuar
- Ligji nr.44/2013, date 14.02.2013 “Per disa ndryshime ne ligjin nr.10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”,
- Ligji nr.10431, date 09.06.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.
- Ligji nr.31/2013, date 14.02.2013 “Per disa ndryshime ne ligjin nr.10431, date 09.06.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit” .
- Ligji nr.10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”,i ndryshuar.
- Ligji nr.10463, date 22.09.2011 “Per manaxhimin e integruar te mbetjeve” , i ndryshuar.
- Ligji nr.156/2013, date 10.10.2013 “Per disa ndryshime ne ligjin nr.10463, date 22.09.2011 “Per manaxhimin e integruar te mbetjeve”,te ndryshuar.

- Ligji nr.32/2013, date 14.02.2013 "Per disa ndryshime ne ligjin nr.10463, date 22.09.2011 "Per manaxhimin e integruar te mbetjeve".
- Ligji nr.9587, date 20.07.2006 "Per mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar
- Ligji nr.68/2014, date 03.07.2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.9587, date 20.7.2006 "Per mbrojtjen e biodiversitetit", te ndryshuar
- Ligji Nr.9048, datë 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar.
- Nr. 162/2014 "Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedisit".
- Ligji nr.37/2013, date 14.02.2013 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.9587, date 20.7.2006 "Per mbrojtjen e biodiversitetit",

➤ **Vendime te Keshilit te Ministrave**

- Vendim i KM nr. 912, date 11.11.2015 "Per miratimin e metodologjise kombetare te procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis"
- Vendim Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"
- Vendim i KM nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
- Vendim i KM nr.99, datë 18.2.2005 "Për Miratimin E Katalogut Shqiptar Të Klasifikimit Të Mbetjeve"
- Vendim i KM nr. 652, datë 14.9.2016, "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura"
- Vendim i KM nr. 371, datë 11.6.2014, "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre".
- Vendim i KM Nr. 765, datë 7.11.2012 për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura.
- Vendim i KM, Nr.866, Dt. 04.12.2012 Për bateritë, akumulorët dhe mbetjet e tyre
- Vendim i KM, Nr.229, Dt :23.04.2014 Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit

- Vendim Nr.994, datë 2.7.2008 për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin

➤ **PERSHKRIMI I PROJEKTIT**

Fshati Vaqarr ne komunen Vaqarr kohet e fundit eshte populluar shume duke u kthyer ne nje zone industriale e ka rritur ndjeshem fluksin e automjeteve qe kalon ne kete aks. Periudha e veres eshte piku i trafikut. Edhe standarti i jeteses ne kete zone ka ardhur vazhdimisht ne permiresim, cka nenkupton edhe nje rritje te numrit te automjeteve qe posedojne banoret. Keto elemente e kane bere te domosdoshem edhe permiresimin e sherbimit ndaj automjeteve si ne cilesi, ashtu edhe ne shumellojshmeri sherbimesh. Ne kete kuader, Personi Fizik Agron GORICA ndertuar dhe ka ne perdorim nje servis makinash me sipefaqe te pergjithshme trualli 1000 m2 dhe siperfaqe ndertimi 250 m2 me ane te te cilit ofron per pronaret e automjeteve nje pike servisi, duke garantuar standarte te larta sherbimi ne kete fushe.

Vendendodhja Objekti Servis - Makina ndodhet ne krahun e djathte te rruges Tirane Ndroq Durres.

Objekti kufizohet:

Ne Lindje	rruge automobilistike
Ne Veri	me prone private
Ne Perendim	me prone private
Ne Jug	me prone private

Objekti ndodhet ne koordinatat: X= 479667: Y= 4574697

Emertimi pershkruesi i veprimtarise sipas licences me nr serial: LN-5933-10-2018 per subjektin Agron Gorica me nr NIPT: K315161770 eshte: a) Riparim dhe mirembajtje e pjeseve mekanike dhe te motorrit, te mjeteve rrugore me motorr dhe rimorkove.
b) Blerja dhe shitja e mjeteve me motorr dhe rimorko.



Proceset dhe mjetet e punes:

Subjekti Agron Gorica, si person fizik ofron nje sere sherbimesh te te gjitha klientet e vet duke ju pergjigjur cdo moment per cdo kerkese. Disa nga sherbimet me kryesore te ofruara jane:

- ✚ Riparim dhe mirembajtje e pjeseve mekanike dhe te motorrit, te mjeteve rrugore me motorr dhe rimorkove
- ✚ Blerja dhe shitja e mjeteve me motorr dhe rimorko
- ✚ Demontimi i automjeteve qe jane ne fund te jetes
- ✚ Pjese kembimi te perdorura per makina, fugona, motorra, vetura

Te gjitha keto sherbime ofrohen nga nje staf i kualifikuar ne kryerjen e proceseve te punes dhe nga teknologjia me e fundit duke ofruar keshtu sherbime te shpejta dhe cilesore. Ky subjekt eshte i fokusuar ne vendosjen e standarteve personale persa i perket sherbimeve duke projektuar me shume pergjegjesi te cdo klient dhe partner qe ka. I orientuar drejt sherbimeve profesionale, servisi do te vazhdoje te ofroje sherbime te tilla si riparim dhe mirembajtje te pjeseve mekanike te makinave, cmontim te tyre dhe shitje te pjeseve. Cdo gje eshte e inspektuar me kujdes nga stafi i punes dhe brenda rregullave etike. Subjekti eshte i dukshem nga rruga per syrin e klientit; makina merret me karotrec para kryerjes se sherbimit dhe transportohet po me karotrec pasi eshte kryer riparimi i duhur, kjo varet edhe nga kerkesat dhe deshirat e klienteles se servisit.

Demontimi i makinave, si proces qe realizohet ne kete servis nenkupton heqjen e te gjitha pjeseve te paperdorshrne qe ndodhen ne nje mjet motorrik, makine, fugon apo motorr dhe zevendesimi i tyre me pjese te reja. Per sa i perket pjeseve te hequra, ato grumbullohen ne nje vend te caktuar ne ambientet e subjektit dhe me pas lihen aty derisa te shiten, te riperdoren ose ne nje trajtim te mevonshem te tyre.



Pamje pas demontimnit te makinave




Foto e pozicionimit ne Asig Geoportal e servisit

Theksojme se ne kete objekt nuk behet lysterje e makinave. Per sa u perket vajrave te perdorura subjekti ne fjale ka te nenshkruar kontraten me shoqerine "Amos-Oil" shpk per transferimin e vajrave te perdorur.



Foto nga mabienti i punes

➤ **PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU PROPOZOHET TE ZBATOHET PROJEKTI**

• **Te pergjithshme**

NJQV Vaqarr ku zhvillon aktivitetin e tij personi fizik Agron Gorica ben pjese ne qytetin e Tiranes, keshtu qe ka karakteristikat e tij. Tirana ndodhet 110 metra mbi nivelin e detit. Lartesia mesatare e fushes se Tiranes eshte 521 m, kurse dy malet me te larta rreze te cileve shtrihet jane Mali i Dajtit me 1612 m dhe Mali me Gropa me 1828 m. Qyteti gjendet rreth 34 kilometra larg detit Adriatik ne perendim. Nga jugu dhe perendimi rrethohet nga kodra relativisht te ulta, kurse nga ana veriperendimore Tirana shtrihet mbi nje zone te rrafshet. Ne periferine veriore

kalon lumi i Tiranës. Disa kilometra më tutje nga ana jugore rrjedh lumi i Erzenit. Sipërfaqja e qytetit të Tiranës është rreth 31 km², ndërsa sipërfaqja e gjithë rrethit është 1288 km² dhe përfshin katër qendra: Tiranën, Voren, Krrabën dhe Kamzën si dhe 150 fshatra. Qendren e Tiranës e përshkon perroi i Lanës i cili në grykëderdhje bashkohet me lumin Ishëm. Në Tiranë mbizoteron një klimë nentropikale-mesdhetare me rreshje dimerore dhe me temperatura mesatare vjetore në korrik + 24° Celsius dhe në janar +7° Celsius. Në vit bie 1 189 mm shi.

- **Flora dhe fauna**

Flora dhe fauna e këtij qyteti nuk ka specie të rralla apo në zhdukje, në bashkinë e Tiranës gjenden bime të ndryshme, shkurre të uleta si dhe bime mjekësore. Nga gjitarët përmenden lloje si dhelpra, cakalli dhe shpende të shumëllojshëm. Në burimet ujore të embla si liqenët gjenden peshq, kurse në kanale të keneta bretkosa dhe lloje insektesh fluturues. Bimesia mbizotërore e këtij fshati karakterizohet nga barishte dhe shkurre të pakta, si dhe lloje të ndryshme druesh frutore dhe jofrutore. Servisi është i ndërtuar dhe nuk do të ndikojë në bimesi. Zona ku ndodhet servisi është e mbuluar nga ndertimet.

- **Informacion për qendrat e banuara (distanca nga qendrat e banuara dhe njësia e qeverisjes vendore që administron territorin ku zhvillohet projekti)**

Vendi i zhvillimit të aktivitetit ndodhet në Tiranë, Vaqarr, rruga Nacionale Tiranë - Vaqarr Zona kadastrale 3712, nr pasurie 300/37. Vendi i projektit gjendet dhe shumë pranë qendrave të banuara, por mund të themi se kjo nuk përben ndikim negativ për mjedisin apo banorët pasi ky aktivitet funksionon si një servis që ka veprimtari kryesore riparimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve mekanike të makinave, nuk kryen aktivitet me çlirim të demshme gazesh apo shkarkimesh të tjera të rrezikshme e me natyrë ndotëse.

Përkundrazi, vendosja e këtij aktiviteti në këto zone sjell vetëm ndikime pozitive sepse punëtoret e punësuar aty janë nga banorët përreth (të nevojshëm për plotësimin e fuqisë punëtore që i duhet aktivitetit), duke rritur kështu mirëqenien e tyre ekonomike. E gjithë zona nuk ka objekte të mbrojtura gjeologjike, apo zona me interes gjeologjik. Mundësia e lëkundjeve të theksuara sizmike është e ulët, pra ndërtimi i këtij objekti në këto territor është studiuar duke arritur në

perfundimin se ky eshte nje pozicion i favorshem strategjik.

- INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE NE SIPERFAQEN E KERKUAR NGA PROJEKTI DHE NE AFERSI TE SAJ.

Zona e Tiranës është e pasur me ujera të cekta nentokesore .. Ujrat e cekta nentokesore në zonën e Tiranës vijnë nga basenet e Ishmit dhe Erzenit, që nga Durrësi. Këto ujera kanë një përmbajtje të pH prej 7 deri 9 dhe janë të pijshëm. Akuiferi i ujerave të Tiranës është shumë i fortë me rreth 18 - 300 dH; niveli mesatar shkon 10 -200 dH maksimali është 250 dH.

- IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS LIDHUR ME AKTIVITETIN

Me pashte paraqitet një analizë e emetimeve në mjedis që mund të vijnë nga ushtrimi i këtij aktiviteti. Për vetë natyrën e veprimtarisë impaktet negative janë të paperfillshme, subjekti i ka marrë të gjitha masat për minimizimin e ndikimeve të mundshme negative në komunitetin dhe mjedisin përreth si: largimi i mbetjeve të ngurta nga vetë subjekti. Edhe zhurmat do të jenë minimale pasi aktiviteti merr masë për mbajtjen nën kontroll të tyre.

1. Ndikimet në popullsi

Realizimi i aktivitetit nuk ka ndikime në levizjen apo zhvendosjen e popullsisë së këtij rajoni ku zbatohet aktiviteti. Gjate zhvillimit të aktivitetit nuk ka emetime në ajër, tokë apo ujë, të cilat ndotin ambientin dhe të rrezikojnë shëndetin e punonjësve apo popullsisë së rajonit. Në zhvillimin e aktivitetit nuk janë parashikuar ndryshime në popullsinë e zonës, të zhvendosjes së saj për shkak të tij. Ky aktivitet nuk ka ndikime negative në shëndetin mendor dhe fizik të popullsisë të ndodhur rreth vendit të ushtrimit të tij.

2. Ndikimet në klimë

Gjate zhvillimit të aktivitetit nuk priten ndryshime të dukshme klimaterike, si në drejtim të përmirësimit ashtu edhe në drejtim të përkeqësimit të saj. Nuk ka ndryshime në temperaturë në

drejtim të erez apo sasise të rreshjeve. Pra, mund të thuhet se kryerja e këtij aktiviteti nuk ndikon fare në kushtet klimaterike të kësaj zone.

3. Ndikimet nga zhurmat

Ndikimet nga zhurmat përfshijnë zhurmat e shkaktuara nga mjetet e punës që përdoren në këte servis, levizjen e mjeteve motorrike që do të riparohen si dhe aktivitetin e punonjësve të punësuar në këte subjekt. Këto zhurma mbahen në nivele të qëndrueshme dhe nuk i kalojnë vlerat e përcaktuara për të nga kuadret ligjore përkatëse .

4. Ndikimet në toke

Mbeturinat e ngurta vijnë nga: aktiviteti human, mbetje urbane të plastikës, qelqit, kartona etj të cilat janë të riciklueshme dhe hidhen në konteneret e mbetjeve urbane të zonës. Përpara hedhjes së tyre në këto kosha, subjekti ka në ambientet e punës disa kosha të tjere të posaçem për grumbullimin dhe hedhjen e këtyre mbeturinave për të mos u depozituar për një kohë të gjatë në ambientet e punës.

5. Ndikimet në ajër

Subjekti ushtron një aktivitet të tillë i cili nuk gjeneron tymra, gaze, aroma, pluhura apo komponente të tjere të demshëm të kësaj natyre. Në ambientet e punës nuk ka as oxhak, as furra djegieje dhe asnjë lloj procesi që të këte lidhje me të. Kështu që ndikimi që subjekti ushtron në ajër është zero.

6. Ndikimet në flore dhe faune

Aktiviteti zhvillohet në një ambient të hapur dhe brenda sipërfaqes së përcaktuar për këte qëllim kështu që nuk ka lidhje me mjedisin tjetër, për rrjedhojë as derdhje të shkarkimeve apo mbeturinave që mund të shkaktojnë ndryshime në floren e faunen e zonës. *Aktiviteti ka një kontratë me shoqërinë e licensuar për vajrat e përdorur. Aktiviteti nuk merret me llyerje të pjeseve të ndryshme apo makinave.*

7. Ndikimet ne zhvillimin e rrugeve lokale dhe te transportit

Aktiviteti nuk ka ndikim ne rruget lokale dhe te transportit, madje subjekti eshte angazhuar ne mirembajtjen e tyre me qellim mbarevajtjen e zhvillimit te aktivitetit te tij pasi ne keto rruge kalojne makinat apo mjetet e tjera motorrike per te ardhur ne servis per riparim apo mirembajtje.

8. Ndikimet mbi trashegimine arkeologjike, kulturore dhe historike

Aktiviteti qe ushtron personi fizik Agron Gorica zbatohet ne nje zone ne siperfaqen e se ciles dhe ne nentoken e saj nuk ka ndertime lidhur me trashegimine arkitektonike dhe historike apo tiparet arkeologjike. Kjo tregon se zona eshte e lire per vazhdimin e ushtrimit te veprimtarise se ketij aktiviteti dhe njekohesisht nje zone ne te cilen aktiviteti nuk shoqerohet me pasoja ndotese per mjedisin.

9. Ndikimet mbi zonat e mbrojtura

Aktiviteti qe ushtron personi fizik Agron Gorica zbatohet ne nje zone ne siperfaqen e se ciles dhe ne nentoken e saj nuk ka zona me status mbrojtje.

➤ PERSHKRIM I SHKARKIMEVE TE MUNDSHME NE MJEDIS

Ky aktivitet nuk ka shkarkime te ujerave teknologjik ne mjedisin perreth. Shkarkime te ujerave te perdorur mund te permendim vetem ujerat higjenosanitare te ambjenteve te tualeteve dhe te larjes e pastrimit te ambjenteve te punes. Keto ujera shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones. Emetime ne ajer nga ky aktivitet vijne kryesisht nga makinerite prerese dhe shpuese te llamarinave, kryesisht pluhur, por kjo ne sasi jo te konsiderueshme. Gjate proceseve te punes, punonjesit perdorin masa mbrojtese si syze, maska per ruajtjen e shendetit te tyre.

Mbetjet qe prodhohen ne kete aktivitet jane: Copeza llamarine, pluhur metali ferroz, nga aktiviteti human, mbetje urbane te tilla si: mbetje plastike, qelqi, qese dhe kartona nga ambalazhet, etj. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje te ngurta, pasi materiali eshte 100% i perdorshem, si pluhuri metalit si copezat shiten per skrap, dergohen per riciklim ne kompanite e licensuara per kete qellim.

➤ INFORMACIONI PER KOHEZGJATJEN E MUNDSHME TE NDIKIMEVE NEGATIVE

Ndikimi i aktivitetit ne kushte normale funksionimi zgjat per aq kohe sa zgjat edhe aktiviteti. Ndikimi ne mjedis zgjat per aq ore sa funksionon aktiviteti ne dite dhe aq dite sa ai funksionon ne vit. Proceset e riparimit dhe mirembajtjes se makinave me motorr e rimorko nuk ndikojne ne mjedisin e zones. Ndikimet ne mjedis per kete lloj aktiviteti konsistojne vetem ne prodhimin e zhurmes brenda mjedisit te servizit si dhe prodhimin e mbetjeve te ngurta e te lengeta (vajra te perdorura) te cilat dergohen per riciklim ne kompanite e licensuara per kete qellim.

➤ SHTRIRJA HAPESINORE E NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDISIN E ZONES

Ndikimi ne mjedisin e zones ne kushte normale te punes, perhapet vetem ne mjediset e servisit. Nuk ka shkarkime te ujerave teknologjik. Ndikimi nga zhurmat do te jete present vetem ne mjediset e punes, ndersa mbetjet e ngurta qe dalin gjate proceseve te punes, te cilat jane mbetje 100% te perdorshme, dergohen per riciklim ne kompanite e licensuara per kete qellim.



Pamje nga parkimi i servisit

➤ REHABILITIMI I MJEDISIT TE NDIKUAR DHE MUNDESIA E KTHIMIT TE TIJ NE GJENDJEN E MEPARSHME

Subjekti investitor, duhet te kujdeset per nje mjedis te paster, te rregullt, te gjelberuar, te sigurte dhe te pajisur me sinjalistiken dhe posterat sensibilizues perkates per kushtet teknike te punes dhe per mbrojtjen e mbajtjen paster te mjedisit. Ne rast te mbylljes se aktivitetit, mund te merret ne konsiderate mundesia e zhvillimit te aktiviteve tregtare e industriale. Ambjentet perreth magazines jane te shtruara me beton, te gjelberuara ne nje brez te gjelber ne te gjithe perimetrin e objektit.

➤ MASAT E MUNDSHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Ne menyre te pergjithshme paraqesim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga zhvilluesi i aktivitetit per mbarevajtjen e punes dhe ruajtjen e mjedisit.

- Ne sheshet jashte aktivitetit, nuk duhet te magazinohen materiale te rrezikshme, nuk duhet te magazinohen mbetje as produkte, ato te ruhen te gjitha brenda sheshit te servisit.
- Te menaxhohen mbetjet e ngurta ne menyre te integruar dhe te zbatohen perkufizimet e Ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve".
- Punonjesit te pajisen dhe te perdorin rregullisht masat mbrojtese ne pune si veshje, maska, syze, tapa per veshet, kufje, etj me qellim ruajtjen e shendetit te tyre.
- Te kryhet monitorim i rregullt i elementeve te mjedisit dhe te shkarkimeve ne ajer dhe zhurmat.
- Te mirembahen siperfaqet e gjelberta perreth objektit, ne qofte se ka.
- Te zbatohet projekti i mbrojtjes ndaj zjarrit.

➤ NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN NDERKUFITAR (NESE PROJEKTI KA NATYRE TE TILLE)

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmtim te mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon ne cenimin e sigurise se jetes dhe shendetit te shteteve fqinje, madje me kushtet qe jane zbatuar deri tani as te qendrave te banuara te zones me te afert. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit ne kontekstin nderkufitar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Zvillimit Ekonomik,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes

LICENCË



QENDRA KOMITARE E LICENCORIT
NATIONAL LICENSING CENTER

LN-7559-02-2014
Subjekti: INSTITUTI DEKLADA - ALB
Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Rruga: "Dora Distria"
Kodi: III.2.A (1+2)
Data e lëshimit: 28/02/2014
Kod tjetër:
Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë
Veprimtari të ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor,
Vlersim i ndikimit në mjedis)

Kategoria
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Kufizime specifike
Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislativonin në fuqi

Nënkategoria
Veprimtari të ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Detyrime specifike
Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislativonin në fuqi

Veprimtari specifike
1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Vendi i kryerjes së veprimtarisë
Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë


Specialiteti

PER SUBJKTIN

AGRON GORICIA

Nënkryetari i sportelit: OKI Balla





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 5128 Prot.

Tiranë, më 22.06 2017

Nr. identifikues 429

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. AGIM HASALAMI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

DER
SUBJEKTIN
AGRON
GORICA

MINISTRI

Lefter KOKA

